

Hyrje

E keni pranë jush vëllimin e parë të edicionit që e kemi titulluar *Libër Kujtimi i Kosovës*, të cilin Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH) dhe Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDH Kosovë) ia dedikon ruajtjes së kujtimit për njerëzit, me emër dhe mbiemër, të cilët janë vrarë për shkak të përkatësisë së vet kombëtare, dhe në mesin e të cilëve ka edhe fëmijë, gra dhe pleq të sëmurë dhe të pafuqishëm. *Libër Kujtimi i Kosovës, Viti 1998* është një përmendore mbi të cilën i kemi gdhendur emrat e të gjithë atyre që e kanë humbur jetën apo janë zhdukur dhunshëm¹ gjatë luftës [konfliktit të armatosur] në Kosovë, duke filluar nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit 1998. Kemi në plan që deri në fund të vitit 2012, t'i botojmë edhe pesë vëllime tjera të *Libër Kujtimit të Kosovës*, në të cilat do të shkruajmë për njerëzit që e kanë humbur jetën apo janë zhdukur dhunshëm gjatë konflikteve të armatosura në periudhën prej muajit janar deri në qershor të vitit 1999, dhe në lidhje me konfliktet e armatosura në periudhën prej fundit të muajit qershor të vitit 1999 deri në fund të muajit dhjetor të vitit 2000. Vendimin për zgjerimin e periudhës së hulumtimit deri më 31 dhjetor 2000 e kemi nxjerrë në bazë të analizimit të të dhënave të siguruar për vrasjet dhe zhdukjet e dhunshme të romëve, serbëve dhe shqiptarëve që lidhen me konfliktet e armatosura dhe që kanë treguar se numri i rasteve të tilla është relevant deri në fund të vitit 2000, por edhe që nuk duhet të mënjanohen as vrasjet e serbëve dhe shqiptarëve gjatë dhunës etnike në muajin mars të vitit 2004.

Kishte rekomandime që t'i ndajmë viktimat civile nga dëmet ushtarake në njerëz. Nuk i pranuam sepse në këtë mënyrë do t'i limitonim rrethanat e pësimit vetëm mbi konstatimet për vdekjen, të cilat do të ishin të privuar për kontekstin në të cilin një civil, ushtar apo polic kanë gjetur vdekjen apo janë zhdukur. I konsideronim edhe paralajmërimet qëllimira lidhur me realitetin tonë – ku familjet shqiptare dhe ato serbe, anëtarët e së cilave e kanë humbur jetën apo janë zhdukur, ende i shohin njëra tjetrën të radhitur në anën armiqësore, dhe se, rrjedhimisht, e udhës do të ishte që t'i përgatisim dy libra, njërin për shqiptarët, tjetrin për serbët dhe të tjerë. Megjithatë, kemi mbetur këmbëngulës që me anë të fakteve të kontribuojmë në ngritjen e kulturës së solidaritetit dhe ndarjes së dhembshurisë me të gjitha viktimat e luftës, sidomos me familjet e viktimave të krimeve të luftës, pa marr parasysh përkatësinë e tyre etnike apo religjioze.

1 Nocioni i zhdukjes së dhunshme është marr nga Propozim Statuti i KOMRA-së, sipas së cilit për person të zhdukur konsiderohet edhe ai person për zhdukjen e të cilit përgjegjësi mbajnë forcat që në konflikt të armatosur luftonin kundër forcave qeveritare, siç janë formacionet që nuk e prezantonin asnjë pushtet shtetëror dhe as që kanë vepruar në interes të pushtetit shtetëror.